

Kumtesë për Media
15 TETOR 2020

ECMI KOSOVA SHËNON MUAJIN TETOR SI MUAJI NDËRKOMBËTAR I VETËDIJËSIMIT PËR KANCERIN E GJIRIT: 01-31 TETOR

Tetori, në të gjithë botën është muaji i ndërgjegjësimit për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit. Muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit është një fushatë vjetore ndërkombëtare që synon të shpërndajë informacion dhe të edukojë njerëzit për rëndësinë e shëndetit të gjirit, për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit te gratë dhe vajzat në të gjithë botën.

Çfarë është kanceri i gjirit

Kanceri i gjirit është një sëmundje ku qelizat e gjirit rriten jashtë kontrollit. Kanceri i gjirit mund të fillojë në pjesë të ndryshme të gjirit dhe mund të përhapet jashtë tij nëpërmjet enëve të gjakut dhe enëve limfatike, pra duke dhënë metastaza. Të dy sekset, si gratë ashtu edhe burrat mund të preken nga kanceri i gjirit, edhe pse ky kancer është shumë më i zakonshëm te gratë.

Disa gra janë në rrezik më të lartë për kancerin e gjirit sesa disa të tjera për shkak të historisë së tyre mjekësore, personale, familjare, ose për shkak të ndryshimeve të caktuara gjenetike.

Sa i përhapur është kanceri i gjirit

Bazuar në të dhënat e Agjencisë Ndërkombëtare mbi Kërkimet mbi Kancerin në Botë (GLOBOCAN), e cila përllëgarit një vlerësim të situatës reale në çdo vend të botës, kanceri i gjirit ka incidencën më të lartë ndër llojet e kancerit që prekin gratë kudo në botë. Pjesa më e madhe e vdekjeve nga kanceri i gjirit ndodh në vendet me të ardhura të ulëta e mesatare, ku shumica e grave me kancer gjiri diagnostikohen në faza të vonshme.

Cilat gra janë të rrezikura për kancerin e gjirit

Kanceri i gjirit prek të gjitha gratë, por rreziku rritet me rritjen e moshës. Përgjithësisht preken moshat mbi 50 vjeç, por kanceri i gjirit mund të shfaqet edhe në moshë fare të reja. Studimet kanë treguar se rreziku për kancerin e gjirit është rezultat i një kombinimi faktorësh.



Cilat janë shenjat e kancerit në gji

Njerëz të ndryshëm kanë shenja të ndryshme të kancerit të gjirit. Por, disa të tjerë nuk kanë shenja fare dhe mund ta konstatojnë kancerin e gjirit vetëm pas një mamografie rutinë. Disa shenja që mund të jenë tregues të kancerit të gjirit janë:

- Një gjëndër apo një kokërr në gji ose nën sqetull. Shumë faktorë mund të shkaktojnë gjëndra në gjoks duke përfshirë edhe kancerin, por jo çdo gjëndër në gji është kancer.
- Trashje ose ënjtje e një pjese të gjirit;
- Ndryshime të lëkurës së gjirit-skuqje, plagë apo dëmtime të tjera të lëkurës së gjirit;
- Skuqje, çarje apo trashje e lëkurës përreth thithit të gjirit, gropëzim i thithit të gjirit;
- Rrjedhje nga gjiri përveç qumështit të gjirit, duke përfshirë edhe gjakun;
- Çdo ndryshim në madhësinë apo formën e gjirit;
- Dhimbje në gji;
- Fryrje apo ënjtje e krahut nga njëra anë-disa herë kanceri i gjirit mund të përhapet edhe në gjëndrat limfatike nën krah dhe të shkaktojë fryrje apo ënjtje të tij. Prandaj, gjëndrat limfatike të ënjtura duhen konsideruar një shenjë e mundshme e kancerit të gjirit;
- Çdo ndryshim tjetër i pazakontë në gji.

Ndryshimet në gji jo detyrimisht do të thonë se një femër ka kancer gjiri. Megjithatë, nëse një femër ka simptomat e mësipërme duhet të shkojë menjëherë te mjeku të kontrollohet.

Më 1 Mars, 2019 Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë, (ECMI Kosovo) filloi zbatimin e projektit tetëmbëdhjetë (18) mujorë “Veprimet ndërkuftare në Sektorin e Shëndetit Riprodhues” të financuar nga Bashkimi Evropian përmes Programit të bashkëpunimit ndërkuftar Mali i Zi-Kosovë 2014-2020. Autoritet Kontraktues për këtë projekt është Ministria e Financave e Malit të Zi - Drejtoria për Financa dhe Kontraktim të Fondeve të Asistencës së BE-së. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në përmirësimin e shëndetit riprodhues të grave në komunat Pejë, Istog, Klinë, Deçan dhe Gjakovë në Kosovë me theks të veçantë duke i targetur gratë nga grupet e cënueshme dhe të marginalizuara. Në mënyrë të veçantë, ky projekt ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të shëndetit riprodhues dhe ndërgjegjësimin e popullatës për mbrojtjen e shëndetit riprodhues.

Për shënimin e muajit tetor ECMI Kosova në kuadër të projektit CARES është duke organizuar një sërë aktiviteteve si:



- + Organizim të kontrollave Parandaluese me gra tek Qendrat e Mjekësisë Familjare ose Spitalet Rajonale në komunat përkatëse;
- + Shpërndarje të Broshurës për Shëndetin Riprodhues e cila është zhvilluar në kuadër të projektit CARES, si dhe shpërndarje të materialeve të tjera promovuese të zhvilluara në kuadër të projektit;
- + Intervista në radio dhe televizion në mënyrë që informacioni mbi rëndësinë e kontrollave parandaluese gjinekologjike të arrijë sa më shumë njerëz;
- + Publikim të dy artikujve që japin informacione rreth kancerit të gjirit.

Për më shumë informata mund të kontaktoni:

Blerta Visoka

Zyrtare e Programit

+383 45 222 206

visoka@ecmikosovo.org

sBardha Hamiti

Zyrtare e Programit

+383 45 444 404

bardha@ecmikosovo.org

ECMI Kosovo



Rreth ECMI Kosovo

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare e angazhuar me çështje të minoriteteve në Kosovë, me qëllim kryesor për të zhvilluar institucione gjithëpërfshirëse, përfaqësuese, të ndjeshme ndaj komunitetit që mbështetin një Kosovë të qëndrueshme dhe multi-etnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, mbështet institucionalizimin e organeve qeveritare të lidhura me komunitetet dhe rrit aftësinë e aktorëve të shoqërisë civile dhe qeverisë për t'u angazhuar me njëri-tjetrin në një mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.

Ky publikim është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e ECMI Kosovës dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se reflekton pozicionin e Bashkimit Evropian.

